

LIGJI PER VETEQEVERISJE LOKALE

("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" nr.5/02 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise se Veriut" nr.202/24)

1.DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 1 Permbajtja e ligjit

(1) Me kete ligj regullohen: kompetencat e komunes; pjesemarrja e drejtperdrejte e qytetareve ne marrjen e vendimeve; organizimi dhe puna e organeve te komunes; administrata komunale; aktet e organeve; prona e komunes; mbikqyrja mbi punen e organeve te komunes; shperndarja e keshillit te komunes; mekanizmat e bashkepunimit ndermjet komunave dhe Qeverise se Republikes se Maqedonise; veteqeverisja vendore; mbrojtja e veteqeverisjes lokale; percaktimi i gjuheve zyrtare ne komuna dhe ceshtje tjera me rendesi per veteqeverisjen lokale.

Neni 2 Emeruesi

(1) Shprehje te vecanta te perdorura ne kete ligj, kane kete domethenie:

- "Komuna" eshte njesi e veteqeverisjes lokale, si bashkesi e banoreve te nje territori te caktuar, e percaktuar me ligj, e cila permes organeve dhe permes administrates si dhe veprimtarive te organizuara publike, mundeson kryerjen e kompetencave te percaktuara me ligj.
- "Dispozitat" jane akte te pergjithshme me te cilat keshilli e rregullon kryerjen e kompetencave te komunes.
- "Bashkepunimi nderkombetar i komunave" eshte cdo veprim i komunave nga Republika e Maqedonise i ndermarre ne perputhshmeri me ligjin, per vendosje te bashkepunimit mes tyre dhe bashkesive lokale ose pushteteve lokale te nje ose me shume shteteve, si dhe anetaresimi i asociacioneve te tyre ne organizata nderkombetare te bashkesive lokale ose pushteteve lokale.
- "Proces i vendosjes" eshte teresia e aktiviteteve te keshillit qe perbehet prej: definimit dhe percaktimit te ceshtjeve te cilat duhet te zgjidhen, propozimeve dhe vendimeve, shqyrtimit dhe sjelljes se dispozitave dhe masave.
- "Pjesemarrja e drejtperdrejte e qytetareve" eshte perfshirja individuale ose kolektive e banoreve te komunes ne marrjen e vendimeve per pune me rendesi lokale ne nivele te ndryshme te vendosjes.
- "Kompetencat e komunes" eshte teresia e puneve me interes publik e me rendesi lokale qe ne perputhshmeri me ligjin, Komuna ka te drejte ti kryej ne territorin e vet dhe mban pergjegjesi per kryerjen e tyre.

7. "Delegimi i ekzekutimit" eshte bartja e kryerjes se puneve te percaktuara nga kompetencat te nje organi, organit tjetër, gjate se ciles puna kryhet ne emer, sipas udhezimeve dhe pergjegjesisë se organit i cili e ka bartur kryerjen.
8. "Pune te interesit publik me rendesi lokale" punohet per interesin e bashkesise se pergjithshme lokale ose pjeseve te saja te vecanta, te percaktuara me ligj.
9. "Kontrata per kryerjen e puneve te interesit publik me rendesi lokale" eshte kontrate me te cilen komuna e autorizon nje person te caktuar juridik ose fizik, qe ne emer dhe ne interes te komunes, te kryej pune me interes publik me rendesi lokale.
10. "Veprimtarite publike" jane organizata joprofitabile per kryerje te sherbimeve publike (ndermarrjet publike dhe entet publike), qe kryejn veprimtari te interesit publik me rendesi lokale.
11. "Sherbime publike" eshte kryerja e puneve te interesit publik me rendesi lokale per shfrytezuesit.
12. "Shfrytezues i sherbimit publik " eshte cdo person fizik dhe juridik qe shfrytezon sherbimet e veprimtarive publike, dhe
13. "Pergjegjesia" eshte obligimi i komunes, respektivisht i personave te zgjedhur ne funksione publike te nivelit lokal, per demin e shkaktuar personave te trete nga veprimet dhe leshimet gjate kryerjes se kompetencave te tyre.

Neni 3 Komuna

- (1) Njesi te veteqeverisjes lokale jane komunat.
- (2) Komunat jane persona juridik.
- (3) Komunat i kryejne kompetencat e tyre permes organeve te zgjedhura drejtpersedrejti nga qytetaret.

Neni 4 Qyteti i Shkupit

- (1) Qyteti i Shkupit eshte njesi e vecante e veteqeverisjes lokale ku realizohen nevojat dhe intereset e perbashketa te qytetareve qe dalin nga karakteri i qytetit te Shkupit, si kryeqytet i Republikes se Maqedonise.
- (2) Dispozitat e ketij ligji vlejne edhe per qytetin e Shkupit, si njesi e vecante e veteqeverisjes lokale, nese me ligjin e qytetit te Shkupit nuk eshte rregulluar ndryshe.

Neni 5 Realizimi i te drejtes per veteqeverisje lokale

- (1) Qytetaret e shfrytezojne te drejten per veteqeverisje lokale te drejtperdrejtshme dhe nepermjet perfaqesueseve ne organet e komunes.

Neni 6 Banoret e komunes

(1) Qytetaret e Republikës së Maqedonisë që kanë vendbanim të përhershëm në territorin e komunes janë banorë të komunes.

Neni 7

Dispozitat e komunes

- (1) Kryerjen e kompetencave të veta komuna e bën sipas statutit dhe dispozitave të tjera.
- (2) Me statutin e komunes rregullohen: organizimi dhe puna e organeve të komunes; organizimi dhe puna e komisioneve të keshillit; kryerja e punëve nga neni 20 i këtij ligji; menyra e informimit të qytetarëve; rastet e përjashtimit të publikut nga seancat e keshillit; menyra dhe procedura e paraqitjes së kërkesave dhe propozimeve për punën e organeve të komunes dhe veprimi me to; menyra e organizimit të tribunave publike; realizimi i anketave dhe grumbullimi i propozimeve nga qytetaret; menyra e kryerjes së obligimeve nga lemta e mbrojtjes në gjendje lufte si dhe çështje të tjera me rëndësi për vetëqeverisjen lokale.
- (3) Aktet e komunes shpallen para se të hyjnë në fuqi.
- (4) Menyra e shpalljes të dispozitave rregullohet me statutin.

Neni 8

Informimi i publikut

- (1) Organet e komunes, komisionet e keshillit dhe veprimtaritë publike të themeluara nga komuna, janë të obliguara pa kompensim t'iu informojnë qytetaret për punën e tyre, si dhe për planet dhe programet që janë me rëndësi për zhvillimin e komunes, në mënyrë të përcaktuar me statutin.
- (2) Komuna është e obliguar qytetarëve t'iu mundësojë qasje në informatat themelore për shërbimet që ua siguron, në mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara me statutin.

Neni 9

Territori dhe emri i komunes

- (1) Komuna ka territorin dhe emrin e vet të përcaktuar me ligj.

Neni 10

Stema dhe flamuri i komunes

- (1) Komuna mund të ketë stemen dhe flamurin e vet.
- (2) Stema dhe flamuri i komunes (në tekstin e metutjeshëm: stema dhe flamuri) dallohet prej stemes dhe flamurit të Republikës së Maqedonisë si dhe prej stemes dhe flamurit të komunave të tjera dhe të qytetit të Shkupit.
- (3) Stema dhe flamuri dallohen edhe prej stemes dhe flamurit të shteteve të tjera, njësive të vetëqeverisjes lokale të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare.

(4) Menyra dhe procedura per percaktimin e stemes dhe flamurit te komunes rregullohet me statutin.

(5) Ministria kompetente per punet qe i perkasin veteqeverisjes lokale mban regjister te stemave dhe flamujve te komunave ne Republiken e Maqedonise.

(6) Stema dhe flamuri mund te perdoren pas regjistrimit ne regjistrin nga paragrafi (5) i ketij neni.

(7) Ministri kompetent per kryerjen e puneve qe i perkasin veteqeverisjes lokale e percakton permbajtjen dhe menyren e udheheqjes se regjistrit nga paragrafi (5) i ketij neni.

Neni 11

Financimi i komunave

(1) Ne perputhje me politiken ekonomike te shtetit, komuna financohet nga burime te veta te te ardhurave dhe nga burime te tjera te financimit.

(2) Burime personale te te ardhurave te komunes jane tatimet lokale, kompensimet dhe taksat.

(3) Komuna ne suaza te percaktuara me ligj, e percakton lartesine e shkalles se tatimeve dhe lartesine e kompensimeve dhe taksave nga paragrafi (2) i ketij neni. (4) Komuna financohet edhe nga dotacionet e shtetit dhe burimeve te tjera te te ardhurave.

(5) Komuna ka te drejte te hyj ne borxh ne tregun e brendshem dhe te jashtem te kapitalit, ne perputhje me ligjin.

(6) Komuna, ne suaza te kompetencave te veta, disponon ne menyre te pavarur me burimet e veta te te ardhurave.

(7) Burimet e te ardhurave te komunes duhet te sigurojne kryerje perkatese te kompetencave te saja te percaktuara me ligj.

(8) Financimi i komunes rregullohet me ligj.

Neni 12

Zhvillimi i viseve jo mjaft te zhvilluara te komunes

Republika siguron mjete per zhvillim te viseve jo mjaft te zhvilluara te komunes, ne pajtueshmeri me kriteret dhe ne menyre te percaktuar me ligj.

Neni 13

Buxheti i komunes

(1) Komuna ka buxhetin e vet.

(2) Ceshtjet qe kane te bejne me buxhetin e komunes rregullohen me ligj.

Neni 14

Bashkepunimi nderkomunal

- (1) Ne kryerjen e kompetencave te veta komunat mund te bashkepunojne ndermjet veti.
- (2) Me qellim te realizimit te intereseve te perbashketa dhe kryerjen e puneve te perbashketa ne kompetencen e komunave, ato mund te bashkojne mjete dhe te formojne veprimtari te perbashketa publike, ne perputhje me ligjin.
- (3) Me qellim te kryerjes se kompetencave te vecuara komunat munden gjithashtu te formojne trupa te perbashketa administrative ne lemenj te caktuara ne perputhje me ligjin.
- (4) Komunat mund te bashkepunojne edhe me njesi te veteqeverisjes lokale te shteteve te tjera, si dhe me organizata nderkombetare te bashkesive lokale, si dhe te anetarsohen ne organizata nderkombetare te pushteteve lokale.
- (5) Ministria kompetente per kryerjen e puneve qe kane te bejne me veteqeverisjen lokale mban evidence per bashkepunimin e realizuar nderkombetar te komunave, ne perputhje me ligjin.

Neni 15 **E drejta e bashkimit te komunave**

Me qellim te mbrojtjes dhe perparimit te intereseve te perbashketa komunat mund te bashkohen ne shoqata, ne perputhje me kete dhe tjetere ligj.

II.THEMELIMI DHE TERRITORI I KOMUNAVE

Neni 16 **Themelimi**

Komuna themelohet per territorin e nje ose me shume vendbanimeve ne te cilat qytetaret jane te lidhur me nevoja dhe interesa te perbashketa ne te cilat ekzistojne kushte per zhvillim material dhe shoqeror dhe per pjesemarrjen e qytetareve ne marrjen e vendimeve per nevojat dhe intereset lokale.

Neni 17 **Territori**

Territori ne te cilin themelohet komuna duhet te paraqese nje teresi me lidhshmeri natyrore gjeografike e ekonomike, me komunikacione ndermjet vendbanimeve dhe gravitim drejt qendres se perbashket, si dhe te kete objekte te ndertuara te infrastruktures dhe objekte te standardit shoqeror.

Neni 18 **Kufijte**

Gjate percaktimit te territorit te komunes mbahet llogari per kufijte e komunave kadastrale, ashtu qe kufijte e komunes te mos i presin kufijte e komunave kadastrale.

Neni 19 **Ndarja territoriale**

(1)Ndarja territoriale e Republikës së Maqedonisë, përcaktimi i territorit, emrat, selite dhe kufijtë e komunave, procedurat për themelimin e komunave (bashkimi, ndarja dhe ndryshimi i kufijve) dhe çështje të tjera në lidhje me ndarjen territoriale, rregullohen me ligj.

(2)Themelimi i komunave të reja, si dhe ndërrimi i selisë së komunave kryhet me ligj.

III. KOMPETENCAT E KOMUNAVE

Neni 20

Kompetenca e përgjithshme

Komunat, në suaza të ligjit, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, kanë të drejtë në territorin e vet t'i kryejnë punët e interesit publik me rendesi lokale, që nuk janë të përjashtuara nga kompetencat e tyre ose nuk janë në kompetencë të organeve të pushtetit shtetëror.

Neni 21

Kompetencat e komunave

(1)Komunat në mënyrë të pavarur, në suaza të ligjit, i rregullojnë dhe kryejnë punët e interesit publik me rendesi lokale, të përcaktuara me kete ose ligj tjetër dhe janë përgjegjëse për kryerjen e tyre.

(2)Me ligjin me të cilin rregullohen kompetencat e tjera të komunave caktohen edhe burimet financiare për kryerjen e atyre kompetencave.

(3)Kompetencat nga paragrafi (1) të këtij neni parimisht janë të plota dhe të pakontestueshme dhe nuk guxojnë të merren ose kufizohen, përveç në rastet të përcaktuara me ligj.

Neni 22

Lista e kompetencave

(1) Komunat janë kompetente për kryerjen e punëve vijuese:

1. Planifikimi urbanistik (urban dhe rural) , dhenia e lejes për ndërtim të objekteve me rendesi lokale të përcaktuara me ligj, rregullimi i hapsirës dhe rregullimi i tokës ndërtimore.

2. Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës - masa për mbrojtje dhe pengimin nga ndotja e ujit, ajrit, tokës, mbrojtja e natyrës, mbrojtja nga zhurmimi dhe rrezatimi jonizues.

3. Zhvillimi ekonomik lokal- planifikimi i zhvillimit ekonomik lokal ; përcaktimi i perparësive zhvillimore dhe strukturale, udhëheqja me politiken ekonomike ; perkrahja e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha dhe të iniciativave në nivel lokal dhe në atë kontekst pjesëmarrja në vendosjen dhe zhvillimin e rrjetit lokal të institucioneve dhe agjensive dhe promovimi i partneritetit;

4. Veprimtaritë komunale -furnizimi me ujë për pije; përcjellja e ujit teknologjik; përcjellja dhe pastrimi i ujërave të ndotura; ndricimi publik; dërgimi dhe trajtimi i ujërave atmosferik; mirëmbajtja e higjienës publike; grumbullimi, transportimi dhe procedimi me mbeturinat e ngurta komunale; rregullimi dhe organizimi i trafikut publik lokal të udhëtareve; furnizimi me gaz natyror dhe energji ngrohëse; mirëmbajtja e varreve, varrezave, krematoriumeve dhe dhenia e shërbimeve mortore; ndërtimi, mirëmbajtja, rekonstruimi dhe mbrojtja e rrugëve lokale, rrugëve dhe objekteve të tjera të infrastruktures; rregullimi i regjimit të komunikacionit; ndërtimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimeve rrugore të komunikacionit, ndërtimi dhe mirëmbajtja

e hapësirës publike të parkimit; menjanimi i automjeteve të parkuara gabimisht; menjanimi i automjeteve të demtuara nga sipërfaqet publike; ndertimi dhe mirembajtja e tregjeve; pastrimi i oxhaqeve; mirembajtja dhe shfrytëzimi i parqeve, gjelberimit, park-pyjeve dhe sipërfaqeve rekreative; rregullimi, mirembajtja dhe shfrytëzimi i shtratit të lumenjve në pjesët e urbanizuara; përcaktimi i emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera të infrastrukturës.

5. Kultura- përkrahja institucionale dhe financiare të enteve dhe projekteve kulturore; kultivimi i folklorit, zakoneve, artizanateve të vjetra dhe vlerave të ngjashme kulturore; organizimi i manifestimeve kulturore; nxitja e formave të llojllojshme specifike të krijimtarisë.

6. Sporti dhe rekreacioni - zhvillimi i sportit masiv dhe i aktiviteteve rekreative; organizimi i shfaqjeve dhe manifestimeve sportive; mirembajtja dhe ndertimi i objekteve për sport; përkrahja lidhjeve sportive;

7. Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve- çerdhe për fëmijë dhe shtëpi të pleqve (pronesi, financim, investime dhe mirembajtje); realizimi i perkujdesjes sociale për persona invalidë; fëmijëve pa prinder dhe perkujdesje prinderore; fëmijëve me probleme edukativo-sociale; fëmijëve me nevojë të vecanta; fëmijëve nga familjet njëprinderore; fëmijëve në rrugë; personave të ekspozuar rrezikut social; personave të prekur nga keqpërdorimi i drogës dhe alkoolit; ngritja e vetedijes së popullatës; strehimi i personave të rrezikuar social; realizimi i së drejtës dhe edukimi i fëmijëve të moshës parashkollore. Kryerja e këtyre kompetencave është në pajtueshëri me Programin Nacional për zhvillim të mbrojtjes sociale;

8. Arsimi- themelimi, financimi dhe administrimi i shkollave fillore dhe të mesme, në bashkëpunim me pushtetin qendror, në pajtueshëri me ligjin, organizimi i transportit dhe ushqimit të nxënësve dhe vendosjen e tyre në konvikte nxënësish;

9. Mbrojtja shëndetësore –të drejtuarit me rrjetin e organizatave publike shëndetësore dhe me objektet nga mbrojtja shëndetësore primare të cilët duhet të përfshijnë përfaqsimin e veteqeverisjes lokale në të gjitha keshillat të të gjitha organizatave në pronesi publike, edukata shëndetësore; përparimi i shëndetit; aktivitete preventive; mbrojtja e shëndetit të punëtorëve dhe mbrojtja gjatë punës; mbikqyrja shëndetësore mbi mjedisin jetësor; mbikqyrja mbi sëmundjet ngjyeshme; ndihmë pacientëve me nevojë speciale (për shembull, shëndeti mental, keqpërdorimi i fëmijëve etj.) dhe lemenj të tjera që do të përcaktohen me ligj;

10. Zbatimi i përgatitjeve dhe ndërmarrja e masave për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale nga shkatërrimet e luftës, nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe nga pasojat e shkaktuara nga to.

11. Mbrojtja kundër zjarrit që e kryejnë njesitë territoriale kundër zjarrit; 12. Mbikqyrja mbi kryerjen e punëve nga kompetenca e sajë dhe

13. Pune të tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Kompetencat nga paragrafi (1) i këtij neni, kryhen në përputhje me standardet dhe procedurat e caktuara me ligj.

(3) Me ligj përcaktohen punët në kompetencë të komunës të cilat ajo është e detyruar të kryej.

Neni 23

Kompetenca e deleguar

(1) Organet e administratës shtetërore mund t'ia delegojnë kryerjen e punëve të caktuara nga kompetencat e veta prefektit, në përputhje me ligjin.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni barten edhe mjetet e parapara në buxhetin e Republikës së Maqedonisë për kryerjen e atyre punëve.

(3) Menyra e kryerjes se puneve nga paragrafi (1) i ketij neni mund t'iu adaptohet kushteve lokale, me respektimin e standardeve te percaktuara me ligj.

(4) Organi i administrates shtetore nga paragrafi (1) i ketij neni ne menyre subsidiare eshte pergjegjes per kryerjen e puneve te deleguara.

Neni 24

Menyra e kryerjes se kompetencave

(1) Per kryerjen e kompetencave te veta komunat mund te themelojne veprimtari publike ne perputhje me ligjin.

(2) Komuna mund t'ua delegeje kryerjen e puneve te caktuara me interes publik dhe me rendesi lokale personave tjere juridik ose fizik, ne baze te kontrates per kryerjen e puneve me interes publik, ne perputhje me ligjin.

(3) Komuna eshte subsidiarisht pergjegjese per kryerjen e puneve te interesit publik nga paragrafet (1) dhe (2) te ketij neni.

IV. PJESEMARRJA E DREJTPERDREJTE E QYTETAREVE NE MARRJEN E VENDIMEVE NE KOMUNE

Neni 25

Format e pjesemarrjes se qytetareve

(1) Qytetaret drejtperdrejte marrin pjese ne marrjen e vendimeve per ceshtjet me rendesi lokale nepermjet iniciativave te qytetareve, tubimeve te qytetareve dhe referendumit ne menyre dhe procedure te percaktuar me ligj.

(2) Shpenzimet per realizimin e pjesemarrjes se drejtperdrejte te qytetareve ne marrjen e vendimeve bien ne ngarkese te buxhetit komunal.

Neni 26

Iniciativa qytetare

(1) Qytetaret kane te drejte t'i propozojne keshillit qe te sjell akt te caktuar ose te zgjedh nje ceshtje te caktuar nga kompetencat e veta.

(2) Iniciative qytetare nuk mund te paraqitet per ceshtje kadrovike dhe financiare.

(3) Per propozimin nga paragrafi (1) keshilli eshte i obliguar qe te debatoje nese e mbeshtesin me se paku 10 % e zgjedhesve te komunes, respektivisht te veteqeverisjes vendore te ciles I dedikohet ceshtja e percaktuar.

(4) Debatin nga paragrafi (3) i ketij neni, keshilli eshte i obliguar ta mbaje me se voni ne afat prej 90 ditesh pas iniciatives se dorezuar dhe t'i informoje qytetaret per vendimin e vet.

Neni 27

Tubimi i qytetareve

(1) Tubimi i qytetareve mund te thirret per territorin e mbare komunes ose per territorin e veteqeverisjes vendore.

(2) Tubimin e qytetareve e therret prefekti i komunes me iniciative te vet, me kerkese te keshillit ose me kerkese te me se paku 10 % te zgjedhesve te komunes, respektivisht te veteqeverisjes vendore te ciles i dedikohet ceshtja e percaktuar.

(3) Organet e komunes jane te obliguara qe ne afat prej 90 ditesh t'i shqyrtojne konkluzat e sjellura ne tubimin e qytetareve dhe t'i marrin parasysh gjate marrjes se vendimeve dhe sjelljes se masave lidhur me ceshtjet qe u dedikohen, si dhe t'i informojne qytetaret per vendimet e veta.

Neni 28

Referendumi

(1) Qytetaret permes referendumit mund te vendosin per ceshtje nga kompetencat e komunes, si dhe per ceshtje te tjera me rendesi lokale.

(2) Keshilli eshte i obliguar te shpall referendum me kerkese te me se paku 20% te zgjedhesve ne komune.

(3) Keshilli mund te shpall referendum per ceshtje nga kompetencat e veta me iniciative te vet.

(4) Vendimi i dalur nga referendumi eshte obligues per keshillin.

Neni 29

Parashtresat dhe propozimet

(1) Cdo qytetare ka te drejte, vet ose bashke me te tjere te paraqese parashtresa dhe propozime per punen e organeve te komunes dhe administrates komunale.

(2) Prefekti eshte i obliguar:

- te krijojte kushte per paraqitjen e parashtresave dhe propozimeve;
- me se voni ne afat prej 60 ditesh nga dita e pranimit te parashtreses, respektivisht propozimit, parashtruesit t'i dorezoje pergjigje me arsyetim dhe
- parashtresat dhe propozimet qe nuk kane te bejne me punet nga kompetencat e organeve te komunes t'i dorezoje deri te organi kompetent dhe per kete ta njoftoje parashtruesin.

Neni 30

Tribunat e hapura, anketat dhe propozime

(1) Gjate hartimit te dispozitave te komunes, keshilli, respektivisht prefekti mundet paraprakisht te organizoje tribuna publike, te realizoje anketa ose te kerkoje propozime nga qytetaret.

V. ORGANIZIMI DHE PUNA E ORGANEVE TE KOMUNES

Neni 31
Organet e komunes

(1) Organe te komunes jane: keshilli dhe prefekti.

Neni 32
Menyra e punes se keshillit te komunes

(1) Keshilli eshte organ perfaqesues i qytetareve i cili vendos ne suaza te kompetencave te komunes.

(2) Per shqyrtimin e ceshtjeve dhe percaktimin e propozimeve nga lemenjt perkatese keshilli nga perberja e vet mund te formoje komisione te perhershme dhe te perkohshme.

(3) Perberja dhe menyra e zgjedhjes se anetareve te komisioneve nga paragrafi (2) i ketij neni rregullohen me statutin.

(4) Perberja e komisioneve nga paragrafi (2) i ketij neni perkon me perfaqesimin proporcional te partive politike ne keshill.

Neni 33
Zgjedhja e anetareve te keshillit

(1) Keshillin e perbejne perfaqesues te qytetareve te zgjedhur ne zgjedhje te pergjithshme, te drejtperdrejta dhe te lira me votim te fshehte.(2) Zgjedhja e anetareve te keshillit rregullohet me ligj.

Neni 34
Numri i anetareve te keshillit

Numri i anetareve te keshillit percaktohet varesisht nga numri i banoreve ne komune dhe nuk mund te jete me pak se nente as me shume se 33 anetare, dhe ate ne komunat me:

banore	anetare te keshillit
deri 5000	9
prej 5001 deri 10.000	11
prej 10.001 deri 20.000	15
prej 20.001 deri 40.000	19
prej 40.001 deri 60.000	23
prej 60.001 deri 80.000	27
prej 80.001 deri 100.000	31
mbi 100.000	33

Neni 35
Statusi i anetareve te keshillit

- (1) Anetaret e keshillit zgjedhen me mandat katervjecar.
- (2) Anetaret e keshillit i perfaqesojne qytetaret dhe ne keshill vendosin sipas bindjeve te tyre.
- (3) Anetari i keshillit nuk mund te revokohet.

Neni 36

Kompetencat e keshillit

(1) Keshilli:

1. Sjell statutin e komunes dhe dispozita te tjera;
 2. Sjell buxhetin dhe llogarine vjetore te komunes;
 3. Percakton shumen e burimeve personale te te ardhurave te financimt te komunes, ne suaza te percaktuara me ligj;
 4. Themelon veprimtari publike ne suaza te kompetencave te komunes dhe bene mbikqyrjen mbi punen e tyre;
 5. Emeron anetare te keshillave drejtues te veprimtarive publike te cilat i themelon;
 6. Sjell programe per pune dhe plane financiare per financim te veprimtarive publike qe i ka themeluar komuna;
 7. I miraton raportet per realizimin e buxhetit dhe llogarine vjetore te komunes;
 8. Vendors per dhenien e lejeve per kryerje te veprimtarise te interesit publik me rendesi lokale ne perputhje me ligjin;
 9. I miraton raportet per punen e veprimtarive publike qe i ka themeluar komuna;
 10. Vendors per menyren e disponimit me pronen e komunes.
 11. Vendors mbi menyren e kryerjes se kontrollit financiar te buxhetit te komunes ne perputhje me ligjin.
 12. Zgjedh personin qe udheheq me njesine rajonale te ministrise per pune te brendshme ne komune, ne perputhje me ligjin;
 13. Shqyrton dhe miraton raportin vjetor per sigurine publike ne territorin e komunes, te cilin e dorezon deri te ministri i puneve te brendshme dhe avokati popullor;
 14. Mund t'i jep rekomandime personit udheheqes te njesise rajonale te ministrise per pune te brendshme nga fusha e sigurise publike dhe sigurise ne komunikacion dhe
 15. Kryen edhe pune te tjera te percaktuara me ligj.
- (2) Nese keshilli nuk i miraton raportet nga paragrafi (1) nenparagrafi (7) dhe (9) te ketij neni mund te ngreje procedure per kryerjen e kontrollit te punes materiale dhe financiare prane organit kompetent per mbikqyrje.
- (3) Personi udheheqes nga paragrafi (1) nenparagrafi 12 i ketij neni eshte zgjedhur nese per te kane votuar shumica e gjithë keshillave te komunave te cilat I perfshin njesia rajonale e ministrise per pune te brendshme.

Neni 37

Konstituimi i keshillit

(1) Seancen e pare te keshillit te ri te zgjedhur e therret kryetari i keshillit nga perberja paraprake me se voni ne afat prej 20 ditesh nga dita e perfundimit te zgjedhjeve.

(2) Nese keshilli nuk thirret ne afatin nga paragrafi (1) i ketij ligji, anetaret e keshillit tubohen vet dhe nen kryesimin e anetarit me te vjeter te keshillit e konstituojne keshillin ne afat prej 10 ditesh pas skadimit te afatit nga paragrafi (1) i ketij neni.

(3) Nese seanca nuk mbahet ne afatin nga paragrafi (2) te ketij neni do te shpallen zgjedhje te reja per anetare te keshillit, ne menyre te percaktuar me ligj.

Neni 38

Betimi

(1) Anetaret e ri te zgjedhur ne seancen konstitutive te keshillit japin dhe nenshkruajne deklarate solemne me kete permbajtje:

“Une (emri dhe mbiemri) solemnisht deklaroje se detyrat dhe obligimet e anetarit te keshillit do t'i kryej me ndergjegje dhe gjate kryerjes se tyre do ta respektoje Kushtetuten, ligjin, dhe dispozitat e keshillit dhe do ta mbroje rendin kushtetues te Republikes se Maqedonise”.

Neni 39

Thirrja e seancave te keshillit

(1) Seancat e keshillit thirren sipas nevojës por me se paku njehere ne tre muaj.

(2) Seancat i therret kryetari i keshillit me iniciative te vet , me kerkese te prefektit ose me kerkese te me se paku 1/4 te anetareve te keshillit me se voni ne afat prej 15 ditesh nga dita e paraqitjes se saje.

(3) Nese ne afat te percaktuar ne paragrafin (2) te ketij neni kryetari i keshillit nuk e therret mbledhjen e keshillit, anetaret e keshillit tubohen vet dhe zgjedhin kryetar per ate seance.

(4) Dita, ora dhe vendi i mbajtjes se seancave te keshillit si dhe propozimi i rendit te dites sipas te cilit do te punohet, detyrimisht shpallen me se voni shtate dite para dites se mbajtjes se seances, ne menyre te percaktuar me statutin.

Neni 40

Thirrja e seances se jashtezakonshme te keshillit

(1) Seance te jashtezakonshme te keshillit therret kryetari i keshillit, me iniciative te vet ose me kerkese te me se paku 1/3 te anetareve te keshillit, ne raste dhe ne menyre te percaktuar me statut.

(2) Ne njoftimin per thirrjen e seances se jashtezakonshme theksohet koha, vendi i mbajtjes dhe rendi i dites se seances.

(3) Keshilli nuk mund t'a nderroje rendin e dites te seances se jashtezakonshme.

(4) Para fillimit te seances detyrimisht votohet per arsyetimin e shkaqeve te thirrjes se seances se jashtezakonshme.

Neni 41

Puna e seancave te keshillit

- (1) Keshilli mund te punoje nese ne seance merr pjese shumica nga numri i pergjithshem i anetareve te keshillit.
- (2) Keshilli vendos me shumice votash nga anetaret e pranishem, nese me ligj dhe me statutin nuk eshte percaktuar ndryshe.
- (3) Dispozitat qe kane te bejne me kulturen, perdorimin e gjuheve dhe shkrimit ne te cilen flasin me pak se 20% nga qytetaret ne komune, percaktimi dhe perdorimi i stemes dhe flamurit te komunes miratohen me shumice votash te anetareve te pranishem te keshillit, me crast patjeter te kete shumice votash te anetareve te pranishem te keshillit te cilet i takojne bashkesive te cilet nuk jane shumice e popullates se komunes.
- (4) Ne seancat e keshillit, parimisht, votohet ne menyre publike.
- (5) Per cdo mbledhje te keshillit mbahet procesverbal.

Neni 42

Publiku ne punen e keshillit

- (1) Keshilli punon ne seanca.
- (2) Seancat e keshillit jane publike.
- (3) Per perjashtimin e prezences se publikut ne seance vendoset nese per te ekzistojne shkaqe te arsyeshme te percaktuara me statut, me dy te treten e votave nga numri i pergjithshem i anetareve te keshillit.
- (4) Ne debatin per buxhetin e komunes, llogarine perfundimtare te buxhetit dhe planet urbanistike, prania e publikut nuk mund te perjashtohet.

Neni 43

Te drejtat dhe obligimet e anetareve te keshillit

- (1) Anetaret e keshillit kane te drejte dhe obligim te jene prezent dhe te marrin pjese ne punen e keshillit dhe ne komisionet e tij te perhershme dhe te perkoheshme.
- (2) Anetaret kane te drejte ne seancat e keshillit te japin iniciativa dhe propozime dhe t'i parashtrojne pyetje prefektit.
- (3) Anetari i keshillit nuk mund te thirret ne pergjegjesi penale ose te arrestohet per mendimin e shfaqur ose per votim ne keshill.
- (4) Punedhenesi eshte i detyruar ta liroje nga puna profesionale anetarin e keshillit per te marre pjese ne seancat e keshillit ose komisioneve ku ai eshte anetar.

(5) Anetaret e keshillit kane edhe te drejta dhe obligime te tjera te percaktuara me statutin dhe dispozitat tjera ne perputhje me kete ligj.

Neni 44

Konflikti i intereseve te anetareve te keshillit

(1) Anetari i keshillit nuk mund te marre pjese ne procesin e sjelljes se vendimeve per ceshtje ne te cilat ai ose bashkeshorti i tij, femija ose kusherinjte deri ne brezin e dyte anesor kane interes personal financiar ose interes tjetër.

(2) Anetari i keshillit eshte i obliguar ta informoje keshillin per ceshtjet per te cilat ai ka interes financiar ose interes tjetër personal.

(3) Anetari i keshillit nuk mund te jete i punesuar ne administraten komunale te komunes ku ai eshte i zgjedhur.

(4) Nga dita e punesimit ne perputhje me paragrafin (3) te ketij neni do te konsiderohet se anetari i keshillit ka dhene doreheqje.

(5) Anetari i keshillit i punesuar ne veprimtarite publike qe i ka themeluar komuna, nuk mund te marre pjese ne marrjen e vendimeve per ceshtje qe kane te bejne me veprimtarine publike ne te cilen eshte i punesuar.

Neni 45

Kompensimet e anetareve te keshillit

Anetaret e keshillit kane te drejte kompensimi per pjesemarrje ne seanca dhe kompensim te shpenzimeve ditore dhe te rruges, ne suaza te percaktuara me ligj.

Neni 46

Nderprerja e mandatit

(1) Anetarit te keshillit i pushon mandati para skadimit te kohes per te cilen eshte zgjedhur:

- nese jep doreheqje;
- ne rast vdekjeje;
- nese me vendim te plotefuqishem, per veper penale, eshte denuar me burgim ne kohezgjatje me shume se gjashte muaj.
- nese paraqitet rast i paperputhshmerise me funksionin anetare i keshillit ne perputhje me Ligjin qe rregullon zgjedhjet lokale;
- nese me vendim te plotefuqishem i merret e drejta e aftesise per pune; dhe
- nese pushon te jete banor i komunes.

(2) Keshilli ne mbledhjen e pare te ardhshme, do ta konstatoje shkakun dhe ditën e nderprerjes se mandatit te anetarit te keshillit, dhe ate:

- ne rastet nga paragrafi (1) nenparagrafi 1, nga dita e mbajtjes se seances dhe
- ne rastet nga paragrafi (1) nenparagrafet 2, 3,4,5 dhe 6 me ditën e plotesimit te kushtit.

(3) Anetarit te keshillit mund t'i merret mandati nese pa aresye mungon nga seancat tri here rradhazi.

(4) Per arsyeshmerine e mungeses nga paragrafi (3) te ketij neni vendos keshilli me shumice votash nga numri i pergjithshem i anetareve te keshillit.

Neni 47

Zgjedhja e kryetarit te keshillit

(1) Kryetari i keshillit zgjedhet nga perberja e anetareve te keshillit, me mandat katervjecar.

(2) Per kryetar te keshillit zgjedhet kandidati i cili ka fituar shumicen e votave nga numri i pergjithshem i anetareve te keshillit.

(3) Nese ne rrethin e pare asnjeri nga kandidatet per kryetar nuk ka fituar numer te mjaftueshem te votave, kalohet ne rrethin e dyte te votimeve per dy kandidatet qe ne rrethin e pare kane fituar me shume vota.

(4) Per kryetar eshte zgjedhur anetari i keshillit i cili ne rrethin e dyte te votimit ka fituar me shume vota.

(5) Deri ne zgjedhjen e kryetarit, seancat e keshillit i therret dhe me ato udheheq anetari me i vjeter i keshillit.

Neni 48

Obligimet e kryetarit te keshillit

Kryetari i keshillit:

(1) I therret dhe udheheq me seancat e keshillit;

(2) Kujdeset per organizimin dhe punen e keshillit dhe

(3) I nenshkruan dispozitat qe i ka sjellur keshilli dhe ne afat prej tre ditesh nga dita e sjelljes ia dorezon prefektit per publikim.

Neni 49

Zgjedhja e prefektit

Prefekti zgjedhet cdo kater vite ne zgjedhje te pergjitheshme, te drejtperdrejta dhe te lira me votim te fshehte ne perputhje me ligjin me te cilin rregullohen zgjedhjet lokale.

Neni 50

Kompetencat e prefektit

(1) Prefekti:

1. E perfaqson dhe prezanton komunen

2. E kontrollon ligjshmerine e dispozitave te keshillit;

3. I shpall dispozitat e keshillit ne gazeten zyrtare te komunes;

4. E siguron zbatimin e vendimeve te keshillit;
 5. E siguron kryerjen e puneve te cilat me ligj i jane deleguar komunes;
 6. Inicon dhe propozon sjelljen e dispozitave nga kompetencat e keshillit;
 7. E propozon buxhetin vjetor te komunes dhe llogarine vjetore te buxhetit te komunes.
 8. E realizon buxhetin e komunes;
 9. Zgjedh drejtore te veprimtarive publike qe i ka themeluar komuna, ne baze te konkursit publik.
 10. Rregullisht e njofton keshillin per kryerjen e kompetencave te veta ne perputhje me statutin;
 11. Vendos ne pune administrave per te drejtat, obligimet dhe intereset e personave juridik dhe fizik, ne perputhje me ligjin.
 12. Sjell rregullore per sistematizimin e vendeve te punes te administrates komunale;
 13. Udheheq me administraten komunale;
 14. Vendos per punesimin, te drejtat, obligimet dhe pergjegjesiste e te punesuarve ne administraten e komunes, nese ndryshe nuk eshte e percaktuar me ligj;
 15. Siguron shfrytezim te drejte dhe ligjor, mirembajtje dhe mbrojtje te prones se komunes, ne perputhje me ligjin dhe statutin; dhe
 16. Kryen pune te tjera te percaktuara me ligj dhe me statutin.
- (2) Prefekti mund te autorizoj nepunes udheheqes se komunes qe te udheheq proceduren dhe te vendos per pune administrative si dhe te nenshkruaj akte.

Neni 51

Kontrolli i ligjshmerise se dispozitave para shpalljes se tyre

- (1) Nese prefekti vlerson se dispozita e keshillit nuk eshte ne perputhje me Kushtetuten dhe ligjet eshte i obliguar qe ne afat prej shtate ditesh nga dita e dorezimit, me vendim t'a nderprese shpalljen e tij, me te cilin do t'i arsyetoje shkaqet e nderprerjes.
- (2) Keshilli eshte i obliguar , ne afat prej 15 ditesh nga dita e shpalljes te vendimit nga paragrafi 1 i ketij neni, ta shqyrtoj vendimin dhe te vendos ne lidhje me te.
- (3) Nese keshilli e verteton dispoziten, prefekti eshte i obliguar ta shpall dhe njekohesisht te paraqese iniciative per ngritjen e procedures per vleresimin e kushtetutshmerise dhe ligjshmerise se dispozites se kontestuar para Gjyqit kushtetues te Republikes se Maqedonise.
- (4) Per iniciativen nga paragrafi (3) te ketij neni prefekti eshte i obliguar qe ta informoje ministrine kompetente per kryerjen e puneve qe i perkasin veteqeverisjes lokale.

Neni 52

Kryerja e funksionit te prefektit

- (1) Prefekti i sapo zgjedhur e pranon detyren nga prefekti i meparshem ne afat prej shtate ditesh prej dites se zgjedhjes.
- (2) Prefekti ne menyre profesionale e kryen funksionin e vet.
- (3) Gjate kohes se ushtrimit te funksionit prefekti nuk mund te kryej detyra tjera profesionale.
- (4) Prefekti nuk mund te merret ne pergjegjesi penale ose te arrestohet per mendimin e shfaqur ne keshill.
- (5) Prefekti cakton se cili nga anetaret e keshillit do ta zevendesoj ne rast pengese ose mungese, ne perputhje me proceduren e percaktuar me statut.

- (6) Anetarit te keshillit i pushon funksioni i anetarit te keshillit gjate kohes kur e zevendeson prefektin.
- (7) Kryetari i keshillit nuk mund ta zevendesoje prefektin.
- (8) Rroga dhe kompensimet e prefektit , si dhe kompensimi per anetarin te keshillit i cili e zevendeson prefektin, rregullohen me ligj.

Neni 53

Konflikti i intereseve te prefektit

- (1) Prefekti nuk mund te emerohet per anetar i organeve mbikqyrese, administrative, kontrolluese te shoqatave tregtare dhe veprimtarive publike.
- (2) Prefekti nuk mund te marre pjese ne procesin e sjelljes se vendimeve per ceshtje ne te cilat ai ose bashkeshorti, femijet ose kusherinjte deri ne brezin e dyte anesor kane interes personal financiar ose interes tjeter.
- (3) Kryetari i komunes eshte i obliguar qe ta njoftoje keshillin per interesin nga paragrafi (2) te ketij neni.
- (4) Ne rast te paragrafit (2) te ketij neni vendimin e sjell njeri nga anetaret e keshillit i zgjedhur ne te njejten menyre si zgjedhet kryetari i keshillit.

Neni 54

Nderprerja e mandatit te prefektit

- (1) Prefektit i nderpritet mandati sipas fuqise se ligjit:
- nese paraqet doreheqje;
 - ne rast vdekjeje;
 - nese me vendim te plotefuqishem eshte i denuar per veper penale me denim me burg ne kohezgjatje mbi gjashte muaj;
 - nese me vendim te plotefuqishem i merret e drejta e aftesise per pune;
 - nese paraqitet gjendja e paperputhshmerise per kryerjen e funksionit ne pajtim me Ligjin qe rregullon zgjedhjet lokale;
 - ne rast te mungeses te paarsyeshme me gjate se gjashte muaj dhe nese pushon te jete banor i komunes.
- (2) per asryeshmerine e mungeses nga paragrafi (1) nenparagrafi 6 te ketij neni, vendos keshilli me 2/3 te shumices se votave nga numri i pergjithshem i anetareve te keshillit.
- (3) Anetari i keshillit qe e zevendeson prefektin, ne afat prej 15 ditesh nga dita e paraqitjes te njerit nga rastet nga paragrafi (1) te ketij neni eshte i obliguar per ate ta njoftoje ministrine kompetente per punet qe i perkasin veteqeverisjes lokale;
- (4) Ministria kompetente per kryerjen e puneve qe i perkasin veteqeverisjes lokale, ne afat prej 15 ditesh nga dita e pranimit te njoftimit nga paragrafi (3) i ketij neni e njofton Qeverine e Republikes se Maqedonise, e cila ne afat prej nje muaj nga dita e pranimit te njoftimit,

konstaton se eshte paraqitur njeri nga rastet e paragrafit (1) te ketij neni dhe njekohesisht inicon procedure per shpalljen e zgjedhjeve te reja per prefekt, ne perputhje me ligjin.

(5) Keshilli, ne afat prej 30 ditesh nga dita e shpalljes se vendimit te qeverise nga paragrafi (4) te ketij neni, do te zgjedh nje nga anetaret e keshillit i cili do ta kryeje detyren e prefektit per periudhen deri ne zgjedhjen e prefektit te ri, ne menyre sic zgjedhet kryetari i keshillit.

(6) Anetarit te keshillit i pushon funksioni anetar i keshillit ne kohen e kryerjes se detyres se prefektit ne perputhje me paragrafin 5 te ketij neni.

(7) Zgjedhjet nga paragrafi 4 te ketij neni nuk do te mbahen nese deri ne periudhen e re zgjedhore ka me pak se gjashte muaj.

Neni 55

Komisioni per marredhenie ndermjet bashkesive

(1) Ne komunen ne te cilen mbi 20% nga numri i pergjithshem i banoreve te komunes, i caktuar ne regjistrimin e fundit te kryer te popullsisë jane perfaqesues te bashkesise perkatese formohet komision per marredhenie ndermjet bashkesive.

(2) Komisionin nga paragrafi (1) te ketij neni e perbejne numer i njejte i perfaqesuesve nga secila bashkesi e perfaqesuar ne komune.

(3) Menyra e zgjedhjes se anetareve te komisionit percaktohet me statut.

(4) Komisioni i shqyrton ceshtjet qe I perkasin marredhenieve ndermjet bashkesive te perfaqesuara ne komune dhe jep mendime dhe propozime per zgjidhjen e tyre.

(5) Keshilli i komunes eshte i obliguar qe t'i shqyrtoje mendimet dhe propozimet nga paragrafi (4) i ketij neni dhe te sjell vendim ne lidhje me ta.

Neni 56

Keshilli per mbrojtjen e konsumatoreve

(1) Per shqyrtimin e ceshtjeve dhe percaktimin e propozimeve te cilet kane te bejne me kualitetin e sherbimeve te veprimtarive publike te komunes, keshilli mund te formoje keshill per mbrojtjen e konsumatoreve, i perbere nga perfaqesues te grupeve me te medha te shfrytezuesve te sherbimeve publike.

(2) Perberja, menyra e zgjedhjes se anetareve dhe fusheveprimi i punes se keshillit nga paragrafi (1) i ketij neni, rregullohen me statutin.

VI. ADMINISTRATA KOMUNALE

Neni 57

Organizimi i administrates komunale

(1) Per kryerjen e puneve nga kompetencat e organeve te komunes organizohet administrata komunale.

(2) Administrata komunale organizohet ne sektore dhe ne njesi. Komuna mund te organizoje inspektorat komunal per kryerjen e mbikqyrjes inspektuese ne kryerjen e puneve ne kompetenca te saja.

(3) Komuna mund të organizojë inspektorat komunal për kryerjen e mbikqyrjes inspektuese mbi kryerjen e puneve nga kompetenca e sajë.

(4) Organizimin, fusheveprimin dhe menyrën e kryerjes së detyrave të administratës komunale i përcakton keshilli, në bazë të propozimit të prefektit.

Neni 58

Statusi i të punësuarve në komune

(1) Të punësuarit në administratën komunale që kryejnë punë profesionale, normativo-juridike, ekzekutive, administrativo-mbikqyrëse dhe zgjidhin punë administrative kanë status të nepunësit shtetëror.

(2) Për punësimin, të drejtat dhe obligimet, sistemin e rrogave dhe kompensimet e rrogave, përgjegjësinë, vlerësimin dhe nderprerjen e marrëdhënies së punës të të punësuarve nga paragrafi (1) të këtij neni do të zbatohen dispozitat e Ligjit për nepunësit shtetëror.

(3) Për të punësuarit në administratën komunale të cilët kryejnë punë administrativoteknike dhe ndihmëse zbatohen dispozitat nga legjislacioni punës.

Neni 59

Perfshirja e bashkësive gjatë punësimit

Gjatë punësimit, në administratën komunale dhe në veprimtaritë publike që i ka themeluar komuna do të mbahet llogari për perfshirje të drejte dhe perkatese të qytetarëve të cilët u perkasin të gjitha bashkësive të perfshira në komune në të gjitha nivelet, si dhe respektimi i kriterëve për kompetencë dhe profesionalizëm.

Neni 60

Obligimet e administratës komunale

(1) Administrata komunale:

1. I përgatit aktet për keshillin dhe prefektin;
2. I përgatit seancat e keshillit, si dhe seancat e komisioneve të tij të përhershme dhe të përkohshme;
3. Kryen detyra profesionale për keshillin dhe prefektin e komunes;
4. E mban kontabilitetin e komunes .
5. E ndjek problematiken e lëmenjve në kompetencë të komunes, kryen analize për gjendjen dhe jep iniciativë dhe propozime për zgjidhjen e tyre;
6. Dorezon informata dhe të dhëna në lidhje me aktivitetet e komunes me kërkesë të organeve kompetente ose në bazë të ligjit;
7. Disponon me dokumentet e komunes dhe i ruan deri në zhdukjen e tyre respektivisht dorezimin në Arkivin shtetëror të Republikës së Maqedonisë; dhe

8. Kryen edhe pune te tjera qe do t'ia caktoje keshilli dhe kryetari i komunes.

Neni 61

Formimi dhe nderprerja e administrates se perbashket

(1) Trupat e perbashketa administrative per kryerjen e kompetencave te vecuara do te formohen ose nderpriten ne baze te vendimit te sjellur me shumice votash nga numri i pergjithshem i anetareve te cdo keshilli te komunes.

(2) Ne baze te vendimeve te paragrafit (1) te ketij neni lidhet kontrate me shkrim ne te cilin percaktohen: komunat te cilat e themelojne trupin e perbashket administrativ; selia e organit te perbashket administrativ, lloji, vellimi dhe menyra e kryerjes se aktiviteteteve; shfrytezimi i objekteve dhe pajisjeve; financimi; menyra e nderprerjes dhe kontrolli i punes se trupit administrativ.

(3) Kontrata nga paragrafi (2) i ketij neni botohet ne "Gazeten Zyrtare te Republikes se Maqedonise".

VII. AKTET E ORGANEVE TE KOMUNAVE

Neni 62

Dispozitat e keshillit

(1) Per kryerjen e detyrave nga kompetencat e veta keshilli sjell dispozita, dhe ate: statut, programe, plane, vendime dhe dispozita te tjera te percaktuara me ligj.

(2) Dispozitat sillen me shumice votash nga numri i pergjithshem i anetareve te keshillit, nese ndryshe nuk eshte percaktuar me kete ose me tjeter ligj.

(3) Dispozitat per kryerjen e te cilave jane te nevojshme mjete financiare patjeter te permbajne edhe dispozita me te cilat definohen burimet dhe lartesia e mjeteve per kryerjen e tyre.

(4) Dispozitat shpallen ne gazeten zyrtare te komunes me se voni ne afat prej shtate ditesh nga dita e sjelljes se tyre.

(5) Dispozitat nga paragrafi (1) i ketij neni hyne ne fuqi dite e tete nga dita e shpalljes, nese me statutin nuk eshte percaktuar ndryshe.

(6) Komuna mban permbledhje te dispozitave te shpallura e cila eshte e hapur per shikim te pergjithshem.

Neni 63

Aktet e prefektit

Per zgjidhjen e te drejtave te vecanta, obligimeve dhe intereseve te personave fizike dhe juridike, prefekti sjell vendime.

VIII. PRONA E KOMUNES

Neni 64 Prona e komunes

- (1) Komuna ka te drejte ne pronesi ne sende, ne para dhe te drejta.
- (2) Vlera e prones se komunes vleresohet dhe shprehet gjate pergatitjes se llogarise vjetore.
- (3) Me pronen komuna disponon dhe ekonomizon si nikoqir i mire, ne menyre te percaktuar me ligj.

Neni 65 Pronesia ne veprimtarite publike

Veprimtarite publike te themeluara nga komuna, jane prone e saj.

Neni 66 Shitja e sendeve ne pronesi te komunes

- (1) Komuna mund te shes sende ne pronesi te komunes vetem nepermjet ankandit publik ne perputhje me ligjin.
- (2) Cmimi shites i sendeve nga paragrafi (1) i ketij neni nuk guxon te jete me i vogel nga vlera e tyre e tregut .
- (3) Mjetet financiare te fituara nga shitja e sendeve ne pronesi te komunes, mund te investohen vetem per perfitim te sendeve te reja ose rikonstruktim te sendeve ekzistuese ne pronesi te komunes.

Neni 67 Dhenia e prones se komunes ne shfrytezim

Sendet ne pronesi te komunes mund tu jepen ne shfrytezim subjekteve te tjere me ane te ankandit publik ne perputhje me ligjin.

Neni 68 Te mirat ne perdorim te pergjithshem

Komuna kujdeset per shfrytezimin ligjor dhe te drejte te te mirave ne perdorim te pergjithshem.

IX. MBIKQYRJA MBI PUNEN E ORGANEVE TE KOMUNES

Neni 69

Llojet dhe menyra e kryerjes se mbikqyrjes

- (1) Mbikqyrja mbi punen e organeve te komunes ne kryerjen e kompetencave te saja e perfshine mbikqyrjen mbi ligjshmerine, kontrollin dhe revizionin mbi punen materiale dhe financiare.
- (2) Mbikqyrja mbi punen e organeve te komunes mbi kryerjen e puneve te deleguara nga kompetencat e organeve te administrates shtetore e perfshine mbikqyrjen mbi ligjshmerine dhe mbikqyrjen mbi efikasitetin.
- (3) Ne rastet e percaktuara me ligj, behet edhe mbikqyrje paraprake e cila e perfshine pelqimin paraprak te dispozitave te komunes.
- (4) Menyra dhe veprimi i kryerjes se mbikqyrjes mbi punen e organeve te komunes eshte percaktuar me ligj.
- (5) Organet e komunes jane te obliguara te bashkepunojne me organet per kryerjen e mbikqyrjes.

Neni 70

Organet per kryerjen e mbikqyrjes

- (1) Mbikqyrjen mbi ligjshmerine e dispozitave te komunes e kryen ministria kompetente per kryerjen e puneve te veteqeverisjes lokale.
- (2) Mbikqyrjen mbi ligjshmerine e punes se organeve te komunes e kryen organet e administrates shtetore.
- (3) Kontrollin e punes materiale dhe financiare te komunes e kryen ministria per finance.
- (4) Revizionin mbi punen materiale dhe financiare te komunes e kryen Enti shtetor per revizion ne perputhje me ligjin per revizion shtetor.
- (5) Mbikqyrjen mbi kompetencat e deleguara e kryen organi i administrates shtetore kompetencat e te cilit i jane deleguar komunes.

Neni 71

Mbikqyrja mbi ligjshmerine e dispozitave te komunes

- (1) Prefekti eshte i obliguar, ne afat prej 10 ditesh nga dita e botimit te tyre, t'i dorezoje dispozitat e komunes deri te ministria kompetente per kryerjen e puneve te veteqeverisjes lokale.
- (2) Nese organi nga paragrafi (1) i ketij neni cmon se dispozita nuk eshte ne perputhje me kushtetuten dhe ligjin, ne afat prej 45 ditesh nga dita e dorezimit te dispozites, sjell vendim per nderprerjen e zbatimit te dispozites, me crast i arsyeton edhe shkaqet e nderprerjes.
- (3) Vendimi nga paragrafi (2) i ketij neni shpallet ne "Gazeten Zyrtare te Republikes se Maqedonise".
- (4) Organi nga paragrafi (1) i ketij neni, ne afat prej 30 ditesh nga dita e shpalljes se vendimit nga paragrafi (1) i ketij neni, deri te Gjyqi kushtetues i Republikes se Maqedonise

paraqet iniciative per vleresimin e kushtetueshmerise dhe ligjshmerise se dispozites se ndaluar.

(5) Nese procedura nuk ngritet ne afatin e caktuar sipas paragrafit (4) te ketij neni nderpritet vlefshmeria e vendimit per ndalesen e zbatimit te dispozites nga paragrafi (1) i ketij neni, dhe dispozita e ndaluar behet ekzekutive.

Neni 72

Revizioni i punes materiale dhe financiare

(1) Enti shtetedor per revizion, kryen revizione te rregullta te llogarive financiare te komunave ne perputhje me ligjin.

(2) Prefekti eshte i obliguar , ne afat prej 30 ditesh nga dita e sjelljes, t'ia dorezoje raportet per kryerjen e buxhetit dhe llogarine perfundimtare te komunes Entit shtetedor per revizion.

(3) Raporti perfundimtar per revizionin i kryer iu dorezohet organeve te komunes, ministrit kompetent per punet e veteqeverisjes lokale dhe ministrit per finance.

Neni 73

Pelqimi paraprak

(1) Nese gjate sjelljes se dispozites se komunes kerkohet pelqim paraprak nga organ tjetër, organi pelqimin e jep me se voni ne afat prej 60 ditesh nga dita kur i eshte dorezuar propozim dispozita.

(2) Nese pelqimi paraprak nuk merret ne afat nga paragrafi (1) i ketij neni, dispozita konsiderohet si e pranuar ashtu sic ka qene e propozuar nga komuna.

X. SHPERNDARRJA E KESHILLIT TE KOMUNES

Neni 74

Shperndarrja e keshillit me vetiniciative

Keshilli i komunes shperndahet nese per ate deklarohet shumica nga numri i pergjithshem i anetareve te tij.

Neni 75

Kushtet per shperndarje te keshillit

(1) Keshilli shperndahet nese:

1. Serish e miraton dispoziten qe paraprakisht eshte anuluar ose nderprere me vendim te Gjyqit kushtetues te Republikes se Maqedonise.

2. Sjell vendim me te cilin rrezikohet sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikes se Maqedonise.
 3. Nuk takohet per nje periudhe me te gjate se gjashte muaj.
 4. Nuk e miraton buxhetin dhe llogarine perfundimtare te buxhetit deri ne 31 mars te vitit vijues.
- (2) Per paraqitjen e njerit nga kushtet nga paragrafi (1) i ketij neni prefekti eshte i obliguar qe menjehere ta njoftoje ministrine kompetente per kryerjen e puneve nga lemia e veteqeverisjes lokale.

Neni 76

Procedura e shperndarjes se keshillit

- (1) Minsitria kompetente per kryerjen e puneve nga lemia e veteqeverisjes lokale, ne afat prej shtate ditesh nga dita e pranimi te njoftimit nga neni 75 paragrafi (2) i ketij ligji, Qeverise se Republikes se Maqedonise do t'i paraqes propozim per shperndarjen e keshillit.
- (2) Qeveria e Republikes se Maqedonise, ne afat prej nje muaj nga dita e pranimi te propozimit nga paragrafi (1) te ketij neni do te sjell vendim per shperndarjen e keshillit sipas fuqise ligjore, te cilin e shpall ne "Gazeten Zyrtare te Republikes se Maqedonise".
- (3) Per periudhen e mbetur zgjedhore do te shpallen zgjedhje te reja per keshill ne perputhje me Ligjin qe rregullon zgjedhjet lokale.
- (4) Zgjedhjet nga paragrafi (3) te ketij neni nuk do te mbahen nese deri te periudha e re zgjedhore ka me pak se gjashte muaj.

Neni 77

Kryerja e puneve te keshillit

- (1) Deri te zgjedhja e keshillit te ri, punet e keshillit i kryen prefekti i komunes.
- (2) Gjate kryerjes se puneve nga paragrafi (1) i ketij neni prefekti nuk mundet:
 - te vendos per ceshtje qe kane te bejne me disponimin e prones se komunes.
 - te vendos per ceshtje ne te cilat ai ose bashkeshorti i tij, femijet ose kusherinjte deri ne brezin e dyte te linjes anesore kane interes financiar ose interes tjeter personal; dhe
 - te sjell dispozita te parapara ne nenin 36 te ketij ligji.

XI. MEKANIZMAT PER BASHKEPUNIM NDERMJET KOMUNAVE, QEVERISE SE REPUBLIKES SE MAQEDONISE DHE ORGANEVE TE ADMINISTRATES

Neni 78

Konsultimi i komunave

- (1) Komunat, ne kohe dhe ne menyre perkatese do te konsultohen gjate procedures se planifikimit dhe sjelljes se vendimeve per ceshtjet qe u perkasin atyre.
- (2) Komunat do te konsultohen per planifikimin e puneve publike gjate pergatitjes se planit hapsinor te Republikes.
- (3) Menyra e konsultimit nga paragrafi (1) dhe (2) te ketij neni do te percaktohet me ligjet nga lemenjt perkates.

Neni 79

Marreveshjet per bashkepunim ndermjet shtetit dhe komunave

- (1) Qeveria, per shkak te koordinimit gjate planifikimit, programimit dhe implementimit te politikave ne fusha te caktuara ose grupe, mund te lidh marreveshje per bashkepunim me nje ose me shume komuna ne lemenj te interesit te ndersjell.
- (2) Kuvendi i Republikes se Maqedonise do te informohet per marreveshjet per bashkepunim nga paragrafi (1) i ketij neni.

Neni 80

Bashkepunimi ndermjet Qeverise dhe komunave

- (1) Qeveria bashkepunon me komunat per ceshtjet qe jane ne interes te tyre dhe ate:
 - ligjet qe kane te bejne me komunat;
 - shuma e dotacionit te pergjithshem qe duhet t'u ndahet komunave gjate vitit vijues kalendarik;
 - burimet e financimit te kompetencave.
- (2) Per bashkepunimin per ceshtjet e theksuara ne paragrafin (1) te ketij neni pergatitet raport ne te cilin perfshihen ceshtjet per te cilat eshte arritur pajtueshmeri dhe ceshtjet per te cilat nuk ka pajtueshmeri.
- (3) Me ligjin qe ka te beje me ceshtjet nga paragrafi (1) i ketij neni deri te Kuvendi i Republikes se Maqedonise dorezohet edhe raporti nga paragrafi (2) i ketij neni.

Neni 81

Shoqata e komunave te Republikes se Maqedonise

- (1) Shoqata e komunave ne te cilen me qellim te mbrojtjes dhe perparimit te intereseve te perbashketa jane bashkuar me shume se 2/3 e komunave nga mbare territori i Republikes se Maqedonise ka te drejte te:
 - bashkepunoje me qeverine per ceshtjet me interes per komunat ne Republiken e Maqedonise;
 - inicoje sjelljen e ligjeve qe kane te bejne me perparimin e veteqeverisjes lokale;
 - jep propozime per projektimin e buxhetit te Republikes se Maqedonise ne pjesen qe ka te beje me ndarjen e mjeteve per komunat te dedikuara per kryerjen e kompetencave te percaktuara me ligj.

- realizon bashkepunim me organizata simotra te vendeve te tjera dhe e prezantone Republiken e Maqedonise ne organizatat nderkombetare te pushteteve lokale;

(2) Shoqata nga paragrafi (1) i ketij neni themelohet, organizohet, funksionon dhe regjistrohet sipas kushteve dhe ne menyre te percaktuar me ligj.

XII. VETEQEVERISJA VENDORE

Neni 82

Themelimi i formave te veteqeverisjes vendore

(1) Ne komune mund te themelohen forma te veteqeverisjes vendore dhe ate:

- ne qytete - bashkesi urbane;
- ne vendbanimet tjera - bashkesi lokale.

(2) Territori per te cilin themelohen bashkesite urbane jane kufijte e njesive urbane, sipas planit urbanistik te qytetit.

(3) Territori per te cilin themelohen bashkesite vendore jane kufijte e komunave kadastrale te vendbanimeve.

(4) Me statutin e komunes, me se afermi percaktohen: format e veteqeverisjes vendore qe themelohen ne territorin e komunes ne perputhje me paragrafin (1) te ketij neni; raportet me organet e komunes; punet ne kompetence te prefektit kryerja e te cilave mund t'i delegohet kryetarit te keshillit te veteqeverisjes vendore; menyra e sigurimit te mjeteve per punet e deleguara dhe ceshtje te tjera te rendesishme per veteqeverisjen vendore.

Neni 83

Kompetencat e bashkesive urbane respektivisht vendore

Banoret, ne bashkesite urbane respektivisht vendore, ne tubimet e qytetareve:

- shqyrtojne ceshtje, marrin qendrimet dhe pergatisin propozime per ceshtje me rendesi te drejtperdrejte dhe te perditeshme per jeten dhe punen e banoreve te atij territori;
- mund te zgjedhin keshill te bashkesise urbane respektivisht vendore, ne menyre dhe me procedure te percaktuar me statutin e komunes.

Neni 84

Zgjedhja e keshillit te bashkesise urbane respektivisht vendore

Keshilli i bashkesise urbane respektivisht vendore zgjedhet ne tubimet e qytetareve te bashkesise urbane respektivisht vendore, ne menyre dhe me procedure qe jane te percaktuara me statutin e komunes.

Neni 85

Zgjedhja e kryetarit te keshillit te bashkesise urbane respektivisht vendore

(1) Keshilli i bashkesise urbane respektivisht vendore, nga rradha e anetareve te vet zgjedh kryetar me mandat kater vjecar.

(2) Per zgjedhjen dhe obligimet e kryetarit te keshillit te bashkesise urbane respektivisht vendore ne menyre perkatese do te zbatohen dispozitat nga neni 47 dhe 48 te ketij ligji.

Neni 86

Delegimi i puneve te formave te veteqeverisjes vendore

(1) Prefekti mund t'ia delegoje kryerjen e puneve te caktuara me interes te drejteperdrejte dhe rendesi te perditeshme per jeten dhe punen e banoreve, kryetarit te keshillit te bashkesise urbane respektivisht vendore, ne menyre te percaktuar me statut.

(2) Me vendimin nga paragrafi (1) te ketij neni percaktohen edhe mjetet per kryerjen e puneve nga paragrafi (1) i ketij neni si dhe menyra e kryerjes se mbikqyrjes mbi kryerjen e tyre.

XIII. MBROJTJA E VETEQEVERISJES LOKALE

Neni 87

Mbrojtja e pozites kushtetuese te komunes

Keshilli dhe prefekti munden te paraqesin para Gjyqit kushtetues te Republikes se Maqedonise iniciative per vleresimin e kushtetueshmerise se ligjeve dhe kushtetueshmerise dhe ligjshmerise se akteve te pergjitheshme te ministrive dhe organeve tjera te administrates shtetore me te cilat crregullohet pozita kushtetuese e komunes te percaktuara me kushtetuten dhe ligjet.

Neni 88

Mbrojtja gjyqsore e komunave

Komunave u garantohet mbrojtja gjyqsore para gjyqeve kompetente lidhur me aktet dhe aktivitetet e organeve te administrates shtetore dhe Qeverise se Republikes se Maqedonise me te cilat pengohet kryerja e kompetencave te percaktuara me ligj.

XIV. GJUHET ZYRTARE NE KOMUNE

Neni 89

Gjuha zyrtare

Ne komuna, gjuha zyrtare eshte gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik.

Neni 90

Gjuhet zyrtare ne komune

(1) Ne komuna gjuhe zyrtare pervec maqedonishtes dhe shkrimit te saj cirilik eshte edhe gjuha dhe shkrimi qe e perdorin me se paku 20 % e banoreve te komunes.

(2) Per perdorimin e gjuheve dhe shkrimeve ne te cilat flasin me pak se 20 % te banoreve te komunes, vendos keshilli i komunes.

XV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE

Neni 91

(1) Statutet ekzistuese te komunave, aktet per organizim dhe pune dhe aktet per sitematizimin e vendeve te punes ne komune do te harmonizohen me dispozitat e ketij ligji me se voni ne afat prej gjashte muaj nga dita e hyrjes se tij ne fuqi. (2) Organet ekzistuese administrative dhe drejtuese te komunave do te organizohen ne administrate komunale ne perputhje me kete ligj ne afat prej tre muaj nga dita e sjelljes se akteve nga paragrafi (1) i ketij neni.

Neni 92

(1) Ministri kompetent per kryerjen e puneve qe i perkasin veteqeverisjes lokale ne afat prej tre muaj nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji do t'i sjell dispozitat nga neni 10 paragrafi (7) i ketij ligji.

Neni 93

(1) Te punesuarit ne komune te cilet deri ne ditën e hyrjes ne fuqi te ketij ligji kane lidhur marredhenie pune ne perputhje me dispozitat e Ligjit per veteqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e R.M-se nr.52/95) vazhdojne te punojne ne vendet e punes ne te cilat jane caktuar dhe ta pranojne rrogen qe e kane marre para hyrjes ne fuqi te ketij ligji deri ne fitimin e statusit te nenpunesit shtetor dhe deri ne fillimin e zbatimit te sistemit terroges, ne perputhje me dispozitat nga Ligji per nenpunesit shtetor ("Gazeta Zyrtare e RM-se nr. 59/2000; 112/2000; 34/2001).

(2) Te punesuarit nga paragrafi (1) i ketij neni jane te obliguar me se voni ne afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji te japin provim kalimtar per kontrollin e njohurive per fitimin e statusit te nenpunesit shtetor ne perputhje me dispozitat e Ligjit per nenpunes shtetor, dhe caktohen ne perputhje me aktin per sitematizim te vendeve te punes ne titull qe i pergjigjet titullit te fituar.

Neni 94

(1) Prefekti i komunes ne afat prej tre muaj nga dita e sjelljes se ligjit, me propozim te Agjensionit, me vendim do ta percaktoje perkatsine e thirrjeve ekzistuese ne komune me grupet dhe tituj te percaktuara me Ligjin per nenpunes shteteror.

(2) Personat e punesuar ne organe drejtuese dhe administrative te komunes te cilet ditën e hyrjes ne fuqi te ketij ligji kane mbi pese vjet stazh pune caktohen ne vende pune ne perputhje me aktet per sistematizim te vendeve te punes ne tituj pa dhene provimin nga paragrafi 1 i ketij neni.

Neni 95

Sekretaret e keshillave te zgjedhur ne perputhje me dispozitat e nenit 29 paragrafi 1 nenparagrafi 13 dhe arqitektet kryesor te qyteteve, te emeruar ne perputhje me dispozitat e nenit 53 te Ligjit per veteqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 52/95), vazhdojne t'i kryejne punet dhe ta marrin rrogen qe e kane marre deri ne kryerjen e mandatit per te cilin jane zgjedhur respektivisht emeruar.

Neni 96

(1) Dispozitat e ligjeve ekzistuese me te cilat regullohen ceshtje qe ne perputhje me kete ligj jane kompetence e komunave do te vazhdojne te zbatohen deri ne harmonizimin e tyre me dispozitat e ketij ligji, por me se voni deri ne 31 dhjetor 2003.

(2) Dispozitat e neneve 17 dhe 18 te Ligjit per veteqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 52/95) do te vazhdojne te zbatohen deri ne harmonizimin e ligjeve te vecanta nga paragrafi (1) te ketij neni.

(3) Te punesuarit, pajisjet, mjetet per pune, arkivi, dokumentacioni nga njesite rajonale e organeve te administrates shteterore, kompetencat e te cilave ne perputhje me kete ligj behen komunale do te merren nga komunat ne menyre dhe nen kushte te percaktuara me ligjet e vecanta te harmonizuara nga paragrafi (1) te ketij neni.

Neni 97

Deri ne sjelljen e Ligjit me te cilin do te rregullohen ceshtjet per financimin e komunave, financimi i komunave do te vazhdoje te behet ne perputhje me dispozitat e Ligjit per veteqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise nr.52/95) dhe Ligjin per buxhetet ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 79/93,3/94,71/96,46/2000 dhe 11/2001).

Neni 98

Statusi i ndermarrjeve publike, enteve publike dhe shoqerive tregetare ne pronesi te shtetit qe kryejne pune me interes publik , kompetencat e te cilave ne perputhje me kete ligj behen kompetence e komunave, si edhe koha dhe menyra e zbatimit te bilansit ndares te kuadrit dhe te prones, ndermjet Republikes dhe komunave perkatese do te percaktohet me ligjet me te cilat do te behet harmonizimi nga neni 96 paragrafi (1) i ketij ligji.

Neni 99

(1) Dispozitat e nenit 34, 50 paragrafi(1) nenparagrafet 9 dhe 52 paragrafi (2) dhe nenet 82, 83, 84 dhe 85 te ketij ligji do te hyjne ne fuqi ne zgjedhjet e ardhshme lokale.

Neni 100

Deri ne sjelljen e ligjit nga neni 45 i ketij ligji anetaret e keshillit do te marrin kompensim per pjesemarrje ne seancat e keshillit pavaresisht nga kohezgjatja e saje me se shumti deri ne 30 % nga neto rroga mesatare ne Republiken e Maqedonise, e paguar ne tre muajt e fundit ndersa kompensimet per shpenzimet e rruges dhe te dites do tu paguhen sipas dispozitave qe u dedikohen nepunesve shteterore.

Neni 101

Deri ne sjelljen e ligjit me te cilin do te rregullohet mbikqyrja mbi vendimet e prefektit te sjellura per pune drejtuese ne kompetence te komunave, mbikqyrjen do ta kryej komisioni per zgjidhje ne procedure administrative te shkalles se dyte per lemi te vecanta administrative prane Qeverise se Republikes se Maqedonise.

Neni 102

(1) Deri ne regjistrimin e shoqates se komunave te Republikes se Maqedonise, Bashkesia e njesive te veteqeverisjes lokale te Republikes se Maqedonise e formuar ne perputhje me dispozitat e nenit 10 paragrafit 5 te Ligjit per veteqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 52/95), vazhdon ti kryeje punet qe i ka kryer deri ne ditën e hyrjes se ketij ligji ne fuqi.

(2) Me regjistrimin e Bashkesise se komunave te Republikes se Maqedonise merren pajisjet, mjete e punes, arkivi dhe dokumentacioni i Bashkesise se njesive te veteqeverisjes lokale.

Neni 103

Bashkesite ekzistuese vendore, respektivisht organet e tyre, vazhdojne me pune me te njejtat kompetenca deri ne zgjedhjet e ardhshme.

Neni 104

Me ditën e hyrjes ne fuqi te ketij ligji nderpritet te vlejje Ligji per veteqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 52/95 dhe 60/95).

Neni 105

Ky ligj hyn ne fuqi ditën e tete nga dita e shpalljes ne "Gazeten Zyrtare te Republikes se Maqedonise".

DISPOZITA TE VLEFSHME KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE NGA NOVELAT E
LIGJIT

I. "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë"
nr.101/08 (Ligji për përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e
qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetëadministrimit lokal)

II. "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.202/24

Neni 4

(1) Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, dispozitat e nenit 54 të këtij ligji, që i referohen procedurës për shpalljen e zgjedhjeve të reja për kryetar komune, për shkak të paraqitjes së njerit prej rasteve për pushim të mandatit të kryetarit të komunes me fuqi të ligjit, nuk do të zbatohet deri në zgjedhjet e para të rregullta për anetare të keshillave komunale dhe Keshillit të Qytetit të Shkupit, për zgjedhjen e kryetarit të komunes dhe kryetarit të Qytetit të Shkupit, të cilat do të mbahen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Në komunën në të cilën për shkak të paraqitjes së njerit prej rasteve të pushimit të mandatit të kryetarit me fuqi të ligjit Keshilli nga radhet e veta ka zgjedhur anetar, i cili do të kryejë detyrën e kryetarit të komunes, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, anetari i zgjedhur mbetet që ta ushtrojë detyrën kryetar i komunes, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, të zgjedhur në zgjedhjet e para të rregullta për anetare të keshillave të komunave dhe të Keshillit të Qytetit të Shkupit, për zgjedhjen e kryetarit të komunes dhe kryetarit të Qytetit të Shkupit, që do të mbahen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.